



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Këshilli Drejtues

Ref.Nr.2913/24

Pejë Dt. 05.11.2024

Në bazë të Rregullores nr. 1194/23 për Ndarjen e Bursave në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datë 04.11.2024 mori vendim në bazë të cilit:

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" NË PEJË
shpall
K O N K U R S
për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2024-2025

I

Kushtet e përgjithshme

- Bursa universitare ndahen për studentët e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në nivelet e studimeve Baçelor dhe Master.
- Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:
 - Të jenë studentë të rregullt të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
 - Të jenë studentë të vitit të dytë e më lartë;
 - Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
 - T'i kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve në afatin e shtatorit;
 - Të kenë notë mesatare të studimeve më së paku 9.0 (nëntë pikë zero) në nivelin Baçelor, ndërsa notë mesatare më së paku 9.5 (nëntë pikë pesë) në nivelin Master;
 - Përfundim bëmë studentët me afësi ndryshe, të cilët nuk duhet të kenë notën mesatare nën 8.0 (tetë pikë zero) në të dy nivelet Baçelor dhe Master.

II

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- Studentët, të cilët i plotësojnë kushtet nga pika dy (2) e këtij konkursi, duhet t'i paraqesin këto dokumente:
 - Kërkesën për bursë drejtuar UHZ-së;
 - Vërtetimin e vitit të regjistruar akademik 2024/2025;
 - Çertifikatën e notave me notë mesatare;
 - Dëshmi se nuk ka vit të përsëritur gjatë studimeve;
 - Të gjitha dokumentet që kërkohen në pikën b, c dhe d duhet të jenë origjinale dhe të lëshuara nga organet kompetente;
 - Kopje të letërnjoftimit.

2. Dokumentet e kompletuara dorëzohen në zyrën për çështje studentore në fakultetet përkatëse.
3. Dokumentet e pakompletuara sipas kriterëve të lartcekura dhe ato që dorëzohen jashtë afatit të përcaktuar në këtë konkurs, nuk do të shqyrtohen .

III

Afati i aplikimit

Afati i aplikimit zgjatë tetë (8) ditë, përkatësisht prej datës 05.11.2024 deri më datë 13.11.2024 në ora 16.00.

IV

E drejta e ankesës

1. Kandidatët e pakënaqur me vendimin e shpallur pas publikimit të rezultateve kanë të drejtë t'i paraqesin ankesë Këshillit Drejtues në afat prej tetë(8) ditësh, nga dita e publikimit të vendimit.
2. Vendimi i Këshillit Drejtues lidhur me ankesën është përfundimtar.

V

Vendimi për kandidatët që janë përfitues të bursës dhe të atyre që ju refuzohet kjo e drejtë do të publikohet në web-faqen e Universitetit - www.unhz.eu